



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 61, DATË 02.10.2024

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 107, DATË 14.12.2023 “PËR MIRATIMIN E NUMRIT MAKSIMAL TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË GJIROKASTËR PËR VITIN 2024”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 02.10.2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për një ndryshim në vendimin nr 107, datë 14.12.2023 “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2024”. Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar Ligji 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM- së nr. 893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për proçedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", Ligjit Nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, Ligjit nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", Vendimit Nr. 514, Datë 20.9.2017 "Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (Lkp)", të rishikuar, Vendimit nr. 113, datë 1.3.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Vendimit nr. 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", VKM nr. 425, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në Institucionet arsimore dhe në Institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", VKM nr. 419, datë 26.06.2024 "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", Vendimit nr. 503, datë 01.08.2024 Për disa ndryshime në Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 625, datë 28.09.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 165, dt. 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave, VKM -së nr. 421, datë 26.06.2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të Zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunës civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike," të ndryshuar", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 113,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

datë 14.12.2023 "Për miratimin e PBA 2024- 2026 dhe buxhetit vjetor 2024", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 107, datë 14.12.2023 "Për Miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2024", Projektit "Ofrimi i Shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Gjirokastrë", Aplikimit nr.3392/1 prot, datë 20.05.2019 për Fondin Social, Njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 5144 prot., datë 29.10.2019 si dhe në Manualin Orientues " Për implementimin e strukturave dhe organikave në njësitë e vetëqeverisjes vendore"

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 2, të vendimit nr 107, datë 14.12.2023 "Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjjirokastrë për vitin 2024" konformë legjislacionit.
2. Aneksi nr 1, i vendimit nr 107, datë 14.12.2023, të ndryshohet sipas aneksit nr 1.1 bashkëngjitur vendimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretar i Këshillit

Etleva-Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

